



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIM I MATURËS SHTETËRORE 2026  
I DETYRUAR - SESIONI I  
GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

SKEMË VLERËSIMI

Gjimnazi dhe gjimnazi gjuhësor

Varianti A

9 qershor 2026

**Shënim:** Vlerësuesit e testeve janë trajnuar, që të vlerësojnë çdo përpjekje të nxënësit dhe të jenë të kujdesshëm, sidomos në pyetjet e hapura, të cilat kanë më shumë mundësi përgjigjeje dhe ku nxënësit shprehen shpesh dhe me përgjigje të përafërta.

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

PJESA I

Zgjidhni jetën

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	A	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	D	1 pikë
Pyetja 8	C	1 pikë
Pyetja 9	D	1 pikë
Pyetja 10	D	1 pikë

---

Pyetja 11                      2 pikë

Përgjigje e plotë:

**Gjymtyrët homogjene:** tërmetet, përmytjet, vullkanet, shkatërrimet, sëmundjet dhe epidemitë.

**Funksioni:** kundrinorë të drejtë.

**2 pikë**                      Nëse nxënësi gjen gjymtyrët homogjene dhe tregon funksionin e tyre sintaksor.

**1 pikë**                      Nëse nxënësi identifikon gjymtyrët homogjene.

**1 pikë**                      Nëse nxënësi përcakton funksionin sintaksor.

**0 pikë**                      Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 12****2 pikë****Përgjigje e plotë:**

- A) Fjali e thjeshtë njëkryegjymtyrëshe emërore.  
 B) Në numrin shumës, emrat ruajnë të njëjtën trajtë me atë të njëjësit.

**2 pikë**

Nëse nxënësi dallon llojin e fjalisë dhe mënyrën e formimit të shumësit.

**1 pikë**

Nëse nxënësi dallon vetëm llojin e fjalisë.

**1 pikë**

Nëse nxënësi dallon vetëm mënyrën e formimit të shumësit ose jep trajtën e emrave në numrin njëjës dhe shumës. ( njëjës: (një) kuti/fije shumës: (ca) kuti/ fije).

**0 pikë**

Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 13****2 pikë****Model përgjigjeje:**

**Shpjegimi :** Autori sugjeron se vetëm duke përjetuar personalisht ndjenja si: vetmia, dhimbja ne mund të kuptojmë më mirë të tjerët. Empatia, aftësia për ta vënë veten në vendin e tjetrit, lind nga përvoja e përbashkët. Ne mund të jemi më të aftë ndihmojmë të tjerët, kur e njohim përvojën e vuajtjes.

**Ose:** i kuptojmë më mirë vuajtjet e dikujt kur i kemi kaluar edhe vetë.

**Ilustrimi :** Do të marr eksperiencën e “vetmisë”. Dhe kur ju të më thoni: “Ndjehem kaq i vetmuar!”, unë mund ta kuptoj pak vetminë tuaj dhe atëherë mund ta ndiejmë njëri-tjetrin pranë e t'i shtrëngojmë dorën.

**1 pikë**

Nëse nxënësi shpjegon qëndrimin e autorit.

**1 pikë**

Nëse nxënësi gjen një ilustrim mbi këtë qëndrim.

**0 pikë**

Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 14****2 pikë****Model përgjigjeje:**

**Folja gjysmëndihmëse:** mund (mund të bëj, mund të mësoni, mund ta ndiejmë etj.)

**Shpjegimi:** Këto folje theksojnë qëndrimin e autorit, e bëjnë tekstin më bindës, orientojnë lexuesin drejt idesë së autorit, theksojnë tonet sugjeruese.

**1 pikë**

Nëse nxënësi identifikon foljen gjysmëndihmëse dhe jep shpjegimin.

**1 pikë**

Nëse nxënësi identifikon vetëm foljen gjysmëndihmëse.

**1 pikë**

Nëse nxënësi jep vetëm shpjegimin.

**0 pikë**

Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 15****3 pikë****Përgjigje e plotë:**

Dhe kur ju të më thoni **se ndiheni kaq të vetmuar**, unë mund ta kuptoj pak vetminë tuaj.

**3 pikë**Nëse nxënësi bën të gjitha ndryshimet: **heqja e thonjëzave, lidhëza ‘se’, përshtatja e gjymtyrëve.****2 pikë**

Nëse nxënësi bën dy nga ndryshimet.

**1 pikë**

Nëse nxënësi bën vetëm një ndryshim.

**0 pikë**

Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 16****3 pikë****Model përgjigjeje:****Karakteristika 1:** Teksti mbyllet me fjali të thjeshta. Fjali nxitëse thirrmore**Karakteristika 2:** Përdorimi i foljeve në vetën e dytë, mënyra urdhërore. Përdorimi i foljeve modale**Efekt i krijuar:** Përfundimi është i hapur dhe sfidues, duke e lënë lexuesin të reflektojë mbi vetveten. Ai nuk jep një përgjigje të prerë, por nxit lexuesin të kërkojë rrugët drejt lumturisë. Përdorimi i vetës së dytë nxit komunikim të drejtpërdrejtë me lexuesin.**3 pikë** Nëse nxënësi gjen dy karakteristika dhe shpjegon efektin e tyre.**2 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm dy karakteristika.**2 pikë** Nëse nxënësi gjen një karakteristika dhe shpjegon efektin e saj.**1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm një karakteristika.**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.***Pyetja 17****2 pikë****Model përgjigjeje:****Interpretimi:** Sipas autorit, ka njerëz që nuk arrijnë të zgjedhin jetën, sepse nuk çmojnë atë në tërësinë e vet, me të mirat dhe të këqijat e saj. Ata e kanë të vështirë të pranojnë që jeta ka edhe momente të vështira të cilat duhen përballuar me kurajë dhe dinjitet. Këto momente na ndihmojnë ta çmojmë jetën dhe të kuptojmë magjinë e saj.**Përgjigje e pjesshme:** Nxënësi mund edhe ta japë përgjigjen edhe duke iu referuar shembujve nga fragmenti.*Dhe ka nga ata të cilët nuk marrin as mundimin t'i zgjidhin këto fije dhe aq më pak ta hapin këtë kuti.***Ose***Ka nga ata që kur e hapin kutinë presin të gjejnë brenda vetëm bukuri, mrekulli dhe hare.***Ose***Dhe mandej çuditën që takojnë në jetë edhe pasiguri, vuajtje, vetmi dhe dëshpërim.***2 pikë** Nëse nxënësi bën interpretimin e plotë .**1 pikë** Nëse nxënësi bën interpretim të pjesshëm.**1 pikë** Nëse nxënësi jep vetëm ilustrimin që i referohet idesë.**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.***PJESA II****Eskili****Prometeu i mbërthyer****Pyetja 18**      **A**      **1 pikë****Pyetja 19**      **B**      **1 pikë****Pyetja 20**      **C**      **1 pikë****Pyetja 21**      **C**      **1 pikë****Pyetja 22**      **B**      **1 pikë**

Pyetja	23	A	1 pikë
Pyetja	24	B	1 pikë
Pyetja	25	A	1 pikë
Pyetja	26	B	1 pikë
Pyetja	27	B	1 pikë

---

Pyetja 28                      4 pikë

**Model përgjigjeje:**

**Ndjenja 1:** dhembshuria, keqardhja

**Ilustrimi:** Lot' të hidhur syt' tanë/Si me vello i mbështjellin

**Ndjenja 2:** admirimi, adhurimi

**Ilustrimi :** Por na dukesh madhështor! / Përmbi shkëmb me pranga turpi

4 pikë	Nëse nxënësi identifikon dy ndjenjat dhe ilustrimet përkatëse.
3 pikë	Nëse nxënësi identifikon vetëm dy ndjenjat dhe një nga ilustrimet përkatëse.
2 pikë	Nëse nxënësi identifikon dy ndjenjat ose një ndjenjë dhe ilustrimin përkatës.
2 pikë	Nëse nxënësi gjen dy ilustrim të saktë (sipas skemës).
1 pikë	Nëse nxënësi gjen një ndjenjë pa ilustrim.
1 pikë	Nëse nxënësi gjen një ilustrim të saktë (sipas skemës).
0 pikë	Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

---

Pyetja 29                      2 pikë

**Model përgjigjeje:**

**Ideja:** Fati paraqitet si një forcë e pashmangshme dhe e paracaktuar.

**Shpjegimi:** Në antikiteti fati i çdokujt është i paracaktuar. Këtij fati nuk i shpëton as Prometeu, i cili, veç të tjerash, ka dhuntinë e parashikimit të tij. Vetë emri Promete, do të thotë parathënës i fatit.

2 pikë	Nëse nxënësi jep idenë dhe shpjegimin.
1 pikë	Nëse nxënësi jep vetëm idenë ose vetëm shpjegimin.
0 pikë	Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

---

Pyetja 30                      2 pikë

**Model përgjigjeje:**

Prometeu është hero tragjik, sepse sfidon pushtetin për një ideal të lartë. Ai nuk i nënshtrohet fatit të paracaktuar. Ai është i vetëdijshëm për vuajtjen që do të përjetojë, por nuk tërhiqet. Qëndresa, krenaria dhe sakrificat për njerëzimin e bëjnë **simbol të rebelimit ndaj pushteteve autoritare.**

**Përgjigje e pjesshme:** Prometeu është hero tragjik, sepse sfidon pushtetin për një ideal të lartë.

**Ose**

Ai është i vetëdijshëm për vuajtjen.

**Ose**

Ai nuk i nënshtrohet Zeusit.

2 pikë	Nëse nxënësi bën interpretimin e plotë.
--------	---

- 1 pikë** Nëse nxënësi bën një interpretim të pjesshëm.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 31** **2 pikë**

**Model përgjigjeje:**

Mungesa fizike e Zeusit e bën figurën e tij më misterioze dhe më kërcënuese, sepse lexuesi e imagjionon përmes pasojave të veprimeve të tij. Sundimi i tij tiranik duket qartë në ndëshkimin që i ka dhënë Prometeut. Si rezultat i kësaj teknike, tensioni dramatik rritet duke çuar drejt pikës kulmore të konfliktit. Kjo nxit te lexuesi një qëndrim më kritik ndaj pushtetit të tij.

- 2 pikë** Nëse nxënësi shpjegon teknikën e përdorur dhe bën interpretim të plotë mbi përfytyrimin që krijohet për Zeusin.  
**1 pikë** Nëse nxënësi shpjegon teknikën e përdorur **ose** bën vetëm interpretimin mbi përfytyrimin që krijohet për Zeusin.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 32** **3 pikë**

**Model përgjigjeje:**

**Figura:** Pashirra ose përsëritja

**Toni:** vajtues, ankues, tragjik

**Shpjegimi:** “Ah, medet, medet!” ka një funksion të fortë emocional dhe stilistik. Ajo shpreh që në fillim të fragmentit dhimbjen e thellë dhe dëshpërimin e Prometeut për padrejtësinë ndaj tij, duke krijuar menjëherë një atmosferë të tensionuar dhe tragjike. Kjo përsëritje e bën emocionin më të drejtpërdrejtë për lexuesin, njëkohësisht tregon gjendjen e rëndë shpirtërore të personazhit dhe e përforcon tonin e gjithë fragmentit.

- 3 pikë** Nëse nxënësi zbulon figurën, tonin dhe shpjegon efektin që krijohet.  
**2 pikë** Nëse nxënësi zbulon figurën dhe tonin.  
**1 pikë** Nëse nxënësi zbulon vetëm figurën.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 33** **3 pikë**

**Model përgjigjeje:**

Atmosfera në fragment është e tensionuar, tragjike, por dhe heroike. Ndëshkimi që i bëhet Prometeut është sa i padrejtë, aq edhe i jashtëzakonshëm. I mbërthyer në shkëmb, i vetmuar, larg njerëzve, ai shfaqet sa tragjik aq edhe madhështor në përballje me sundimin despotik të Zeusit.

**Detajet që mund të përdorë:** i mbërthyer me pranga; i kryqëzuar në shkëmb; torturat që heq e vuan; lodër në duart e erës bredharake, në agoni po përpëllitet; as kërcënimet dot s'më trembin etj.

**Kujdes!** Detajet do të vlerësohen edhe nëse nuk janë dhënë të përfshira brenda përshkrimit.

- 3 pikë** Nëse nxënësi bën një përshkrim të plotë me detaje nga fragmenti, përdor gjuhë përshkruese dhe leksik të zgjedhur.

- 2 pikë** Nëse nxënësi bën një përshkrim të pjesshëm pa përdorur detajet.  
**1 pikë** Nëse nxënësi identifikon idealin e së ardhmes në liri.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

### PJESA III

#### Pyetja 34 8 pikë

Për pjesën ese do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme:

#### Shtjellimi i idesë 2 pikë

- shkruan një ese, e cila mbështetet në idenë e Leo Buscaglias mbi arritjen e lumturisë si qëllimin më të lartë të jetës, duke u mbështetur në leximet ose në çdo përvojë personale të nxënësit;
- shtjellon përjetime nga ngjarje të cilat kanë ndikuar në jetën e tij;
- shtjellon ngjarje që i kanë ndryshuar këndvështrimin për botën;
- sjell përfytyrime në formën e historive të krijuara;
- zbërthen bërthamën e temës së dhënë .

#### Organizimi dhe struktura 2 pikë

- përdor strukturë të qartë eseje: hyrje – zhvillim – mbyllje;
- siguron kalimin rrjedhshëm në paragrafët zhvillues;
- grupon çështjet në paragrafë të organizuar drejt, qartë, saktë dhe në mënyrë të plotë e të logjikshme;
- zgjedh dhe përdor konektorët e duhur për të siguruar koherencën dhe kohezionin e tekstit. Këta janë të shumëllojshëm dhe i shmangen fjalorit të gjuhës së përditshme;
- përcjell konkluzionin personal në raport me temën (paragrafi përmbyllës).

#### Stili dhe origjinaliteti 2 pikë

- përdor një gjuhë të qartë dhe origjinale, për krijimin e një përshtypjeje të plotë për atë që shprehet në raport me temën;
- përdor një gjuhë të pasur me detaje të shumta që mbështetin idenë dhe që ndikojnë dhe vënë në lëvizje imagjinatën e lexuesit;
- përdor gjuhë subjektive dhe shpesh format shpjeguese gërshetohen me detaje përshkruese;
- përdor fjalor të pasur dhe të shumëllojshëm, me shprehje të zgjedhura që sigurojnë origjinalitet në shkrim dhe dëshmojnë për një formim të mirë jo vetëm letrar, por edhe gjuhësor.

#### Saktësia gjuhësore 2 pikë

- përdor drejt struktura të fjalive, të cilat mbështetin nga pikëpamja gjuhësore përmbajtjen e esesë;
- shkruan pa gabime fjalë të përdorimeve të shpeshta (ose jo), si dhe ndërton drejt, sipas kuptimit apo kumtimit, të gjitha llojet e fjalive;
- përdor saktë shenjat e pikësimit, të të gjitha llojeve: pikë, presje, dy pika, pikëçuditëse, pikëpyetje, vizë ndarëse etj., gjë që dëshmon për njohje shumë të mirë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- shkruan saktë nga pikëpamja e drejtshkrimit, sintaksës e pikësimit, gjë që mbështet në mënyrë të plotë strukturën e fjalive.

*Shënim: Në vlerësimin e esesë, rubrikat që do të vlerësohen nuk mund të shihen të palidhura me njëra-tjetrën, pasi ato nuk mund të kenë një mëvetësi të plotë, ato shihen në harmoni. Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përpjekje të*



